

ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2021: PROGRAMET E PARTIVE POLITIKE DHE AGJENDA E GJELBËR

01/2021

SHKURT 2021

Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2021: Programet e Partive Politike dhe Agjenda e Gjelbër

Autor: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Programi: Zhvillimi i qëndrueshëm

Data e publikimit: Shkurt 2021

Foto e ballinës: Unsplash



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	1
Metodologjia	2
Agjenda e Gjëlber dhe programet e partive politike	2
Dekarbonizimi.....	3
Energjia	3
Ekonomia qarkore	5
Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës	6
Biodiversiteti dhe mbrojtja e ekosistemeve.....	6
Përfundime dhe Rekomandime	6

Hyrje

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 14 shkurtit 2021, vijnë në një kohë kur pyetje të rëndësishme në sektorin e energjisë, mjedisit dhe klimës kërkojnë përgjigje. Në të njëjtën kohë, cilado Qeveri e ardhshme, do t'i duhet të përballet me pandeminë COVID-19 dhe administrimin e vaksinave, rimëkëmbjen e një sektori privat të dëmtuar etj. Gjithashtu, këto zgjedhje zhvillohen në kontekstin e një administrate të re amerikane dhe dilemave mbi formatin, kohëzgjatjen dhe epilogun e një dialogu të stërzgjatur me Serbinë. Megjithatë, agjenda e gjelbër mbetet ndër çështjet më të rëndësishme që do të testoj suksesin e cilëso qeverisje.

Samiti i Sofjes dhe nënshkrimi i Deklaratës së përbashkët ishte një moment shpresëdhënës për Ballkanin Perëndimor. Udhëheqësit e rajonit, përfshirë edhe Kryeministrin e Kosovës, morën zotimin dhe përkushtimin për t'u angazhuar në dekarbonizim të plotë deri në vitin 2050. Në këtë mënyrë është e arritur që vendet e Ballkanit, përfshirë Kosova, të marrin përsipër një përkushtim i cili pritet të konkretizohet me masa të veçanta dhe me implementim të politikave nga secili shtet në mënyrë që të arrihet jo vetëm dekarbonizimi por përfundimisht rritja e kualitetit të jetës përmes ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit publik dhe adaptimit të masave të gjelbra.

Marrëveshja e Parisit mbi klimën është ringjallur si asnjëherë më parë me ndryshimin e administratës amerikane dhe rifutjen e SHBA-ve në përkushtimet e kësaj marrëveshje. Në këtë mënyrë, skena politike evropiane dhe më gjerë është jashtëzakonisht e përgatitur që të shtyjë përpara çështjet e gjelbra përfshirë temat e dakorduara në Samitin e Sofjes. Prandaj, roli i partive politike në njohjen e këtyre dinamikave dhe planifikimin e këtyre politikave është i domosdoshëm.

Kosova gjithashtu mëton që së shpejti të jetë anëtare e Kombeve të Bashkuara. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) ofrojnë një kornizë shumë të mirë të matjes së progresit në rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe sigurimin e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm. Për këtë, kjo dekadë deri në vitin 2030 do të jetë esenciale në mbërritjen e këtyre objektivave. Kosova dhe Qeveria e ardhshme ka mundësinë unike që të përgatitet për këtë proces duke kodifikuar investimet dhe politikat brenda kësaj kornize dhe duke mbledhë të dhëna të plota dhe hartuar raporte të zbatimit.

Përfshirja e agjendës së gjelbër në planifikimin e politikave publike paraqet edhe një shprehje të vullnetit për të absorbuar miliarda euro të zotuar nga Bashkimi Evropian. Nga programi IPA III, vetëm për periudhën 2021-2027, për Ballkanin perëndimor janë paraparë rreth 9 miliard euro.¹ Përfshirja e agjendës së gjelbër në prioritetet e partive politike do të përbente hap të rëndësishëm për përgatitjen e Kosovës për të absorbuar këto fonde. Ky punim synon pikërisht të kthejë vëmendjen e munguar për agjendën 2030 nga diskursi publik në prag të zgjedhjeve të 14 shkurtit dhe pas zgjedhjeve në periudhën e formimit dhe konsolidimit të Kuvendit dhe Qeverisë së re.

¹ Komisioni Evropian, (2020), Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of The Regions, faqe 1, i qasshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/communication_on_wb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf (qasur në shkurt ,2021)

Metodologjia

Ky hulumtim dhe kjo analizë janë realizuar duke përdorur një metodë të përzier kualitative dhe kuantitative. Në pjesën e parë të punës, ne ndërtuam modelin analitik duke u bazuar në kërkesat që vinin nga dokumenti i Bashkimit Evropian “Udhëzues për Implementimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor”. Gjithashtu, për disa nga pjesët e punimit, veçanërisht ato që ndërlidhen me energjinë dhe klimën, ne kemi përdorur edhe indikator nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pasi ndërtuam modelin analitik, të dhënat u mbledhën dhe u kuantifikuan me metodën kuantitative dhe pastaj iu nënshtruan analizës kualitative për të nxjerrë përfundime të veçanta. Qasja fillestare që e menduam ishte ajo krahasuese. Megjithatë, kjo qasje kishte limitet e saj duke marrë parasysh që partitë politike kanë përgatitur programet në forma të ndryshme. Disa subjekte kanë analizuar më shumë problemet sesa të tjerat ndërsa subjektet politike kanë shpjeguar masat në masë të ndryshme dhe në të shumtën e rasteve pa përkrahur shumë detaje të mënyrës së realizimit, kostove etj. Kjo e ka bërë krahasimin më sfidues. Një tjetër sfidë ka qenë edhe koha e vonshme e publikimit të programeve të partive politike. Shumica prej tyre kanë publikuar atë në ditët e fundit e madje edhe në javën e fundit para të dielës së 14 shkurtit.

Megjithatë, pasi kemi identifikuar dhe kuantifikuar masat, ne kemi hartuar një analizë që kombinon atë që duket në grafikon bashkë me një analizë të përgjithshme të kualitetit të propozimeve të bëra. Përmes analizës së përmbajtjes ne kemi analizuar programet duke ndarë gjetjet sipas temave dhe jo sipas partive. Ajo që mbetet për të ardhmen është të shihet nëse partitë do të reflektojnë këto programe në programin qeverisës kurdo që Qeveria e re të formohet.

Për qëllim të hartimit të kësaj analize, ne kemi analizuar programet me shkrim të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Partisë Demokratike të Kosovës (AAK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Agjenda e Gjelbër dhe programet e partive politike

Agjenda e Gjelbër për Kosovën në kuptim të kësaj analize përbën kornizën e propozuar si Udhëzues nga ana e Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky udhëzues detajon pesë shtyllat e Axfordës së Gjelbër: (1) veprimi për klimën, duke përfshirë dekarbonizimin, energjinë dhe mobilitetin, (2) ekonomi çarokore, duke adresuar në veçanti mbetjet, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve, (3) biodiversitetin, me qëllim mbrojtjen dhe rivitalizimin e pasurisë natyrore të rajonit, (4) luftimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës dhe (5) sisteme të qëndrueshme të ushqimit në zona rurale.² Këto pesë shtylla përbëjnë boshtin e politikave për të ndërtuar një politikë që reflekton agjendën e gjelbër për Ballkanin në përgjithësi dhe Kosovën në veçanti.

Agjenda e Gjelbër synon t'i ofroj Kosovës një kornizë më të gjerë të politikave, për një periudhë më afatgjate. Krahas kësaj, duke përfshirë atë në programet politike, partitë kanë mundësinë të


² Komisioni Evropian, (2020), Guidelines for the Implementation of the Green Agenda for the Western Balkans, faqe 2, i qasshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf (qasur në shkurt, 2021)

prioritizojnë çështjet që ndërlidhen me agjendat e tyre politike dhe që janë në interes të përgjithshëm të zbatimit të agjendës.

Dekarbonizimi

Strategjia aktuale e energjisë në Kosovë 2017-2026 është tashmë e vjetruar për shkak se ajo orbitën kryesisht përreth idesë për ndërtimin e një termocentrali të ri me qymyr. Pas dështimit të projektit për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” dhe zhvillimit të hovshëm të tregut dhe politikave evropiane për energjinë nga burimet e ripërtrishme, paraqitet nevoja për një strategji të re dhe qasje të re në fushën e energjisë. Dekarbonizimi është ndër sfidat më të mëdha të politikëbërjes dhe përkthimi i përkushtimit të marrë në Samitin e Sofjes në politika konkrete do të kërkoj qasje gjithëpërfshirëse dhe një strategji të re e afatgjate të energjisë.

Në pjesën e dekarbonizimit, subjektet politike në masën më të madhe të tyre kanë dështuar që të përfshijnë një afat të qartë kohor dhe masa konkrete në këtë drejtim. Grafikoni në vazhdim tregon që vetëm Partia Demokratike e Kosovës ka përmendur atë si opsion dhe atë vetëm në një masë të vogël dhe jo të qartë. Madje, kjo është jokonsistente me faktin që PDK në njërin anë përmend dekarbonizimin pas vitit 2030, e në anën tjetër ende propozon ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”.



“Po ashtu, synohet dekarbonizimi i sektorit të energjisë, për periudhën 2030 e tutje.”


Programi i PDK-së, faqe 75

Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk e kanë përmendur fare dekarbonizimin si koncept, ani pse ai përbën shtyllën e parë të agjendës së gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Partitë politike gjithashtu nuk kanë përmendur fare skemën e tregtimit të emërtimeve, taksën në karbon dhe mundësinë e hartimit të Ligjit për Klimën. Asnjë nga subjektet që garojnë në zgjedhjet e sivjetme nuk e ka të qartë cilat do të jenë politikat sociale në procesin e dekarbonizimit dhe tranzicionit energjetik.

Energjia

Në pjesën e efikasitetit disa nga subjektet politike kanë paraparë masa që nuk janë konkretizuar me shpjegim të veprimeve, afateve kohore, kostove dhe mënyrave të financimit. Lëvizja Vetëvendosje ka përmendur “mbështetje shtesë për bizneset që promovojnë masa të efikasitetit” por nuk kanë

shpjeguar më tutje se çfarë nënkuptohet me këtë mbështetje dhe cilat do të jenë masat që pritet të merren bashkë me detaje tjera kohore dhe financiare.



Mbështetje shtesë do ketë për bizneset në sektorë ekonomik që promovojnë eficiencën e energjisë dhe ruajnë ambientin, ndërmarrësit që mundësojnë përpunimin e mëtejshëm të ushqimit, drurit, apo promovojnë turizmin e vendit.

Lëvizja Vetëvendosje

Kursimi i energjisë në masën prej 30-32 % përmes implementimit të masave të ndryshme të eficiencës në të gjithë sektorët (që gjithsejtë janë pesë: amvisëri, shërbime, transport, bujqësi dhe industri);
 Funkcionalizimi i fondit për eficiencë të energjisë, duke mundësuar disbursimin e mjeteve financiare për bizneset dhe amvisëritë.
 Eficiencë të energjisë në objekte;

Partia Demokratike e Kosovës

Investimi në rritje në ndërtesat publike dhe banesore përfshirë ngrohjen qendrore, do të zvogëlojë konsumin kombëtar të energjisë elektrike të Kosovës me rreth 600 GWh deri në vitin 2030, sipas studimit të opsioneve të Bankës Botërore; Investimi në interkoneksion: Vënia e plotë në punë e interkonektorit 400 kV/600 MW në Shqipëri dhe ndërtimi i interkonektorëve të ngjashëm mund të ulin koston e plotësimit të kërkesës, duke lejuar importe që kushtojnë më pak se termocentralet e reja

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Partia Demokratike ka qenë pak më konkrete në kuptimin që ka përmendur cakun 30-32% si target për kursim të energjisë. Ky nivel i kursimit pritet të zyrtarizohet për Kosovën si pjesë e caqeve të reja të energjisë deri në vitin 2030. Programi i LDK-së vetëm shprehet se “do të ketë mbështetje për eficiencën e energjisë“ pa detajuar se në çfarë formash do të jetë kjo mbështetje dhe cilat do të jenë masat që do të propozohen. AAK ka përmendur ngrohjet qendrore si mundësi për të ulur konsumin kombëtar të energjisë por gjithnjë duke cituar studimin e Bankës Botërore por pa sqaruar kostot, mënyrat e pagesës etj.

Dy nga subjektet politike kanë propozuar termocentral nga qymyri. Partia Demokratike e Kosovës edhe më tutje insiston në ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” ani pse tanimë jo vetëm që Banka Botërore është tërhequr nga financimi dhe Sekretariati i Komunitetit Evropian ka iniciuar procedurë hetimore ndaj Kosovës por edhe vet Contour Global është tërhequr tashmë nga ky projekt. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka propozuar dy termocentrale të reja:


Ne do t’i ndërtojmë dy termocentrale për të siguruar furnizimin bazë me energji elektrike;

- Termocentrali Kosova e Re me kapacitet 300 MW/h – do të ndërtohet në infrastrukturën ekzistuese të KEK-ut (Kosova B) në komunën e Obiliqit;
- Termocentrali me gaz, me kapacitet 300 MW/h – do të ndërtohet në Rrafshin e Dukagjinit. Kështu do t’i kemi 5256 GWh në vit.³

Premtimet për termocentrale të reja të bazuara në qymyr apo djegie fosile bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të gjithë idenë e agjendës së gjelbër dhe deklaratën e Samitit të Sofies për Ballkanin përëndimor. Investimet në qymyr janë

Ekonomia qarkore

Subjektet politike që garojnë në këto zgjedhje, në programet e tyre të shkruara politike nuk kanë ndonjë plan të veçantë për organizimin dhe promovimin e ekonomisë qarkore, benefiteve, kostove dhe planeve me kohështirje për realizimin e tyre. Ekonomia qarkore ka zënë vend të paktë në programet e partive politike. Të gjitha partitë, përveç Lëvizjes Vetëvendosje e kanë përmendur në programet e tyre politike trajtimin e mbeturinave. Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës përmendin partneritetin publiko-privat si metodë për të nxitur aktivitet ekonomik nga trajtimi i mbeturinave që nga mbledhja tek përpunimi i tyre. Sidoqoftë, në përgjithësi, programet dështojnë të jenë të detajuara dhe të thelluara në mënyrat e financimit, afatet e përfundimit të masave etj.



³ Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, (2021), Programi Zgjedhor 2021-2025, i qasshëm në https://aak-ks.com/aak_pz_2021-2025.pdf (qasur në shkurt, 2021)

Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës

Ndotja e ajrit, tokës dhe ujit përbëjnë ndër shqetësimet më të mëdha të shëndetit publik dhe adresimi i tyre është i domosdoshëm në rrugën e integritit evropian. Lëvizja Vetëvendosje ka qenë mjaftë e përgjithshme në platformën e saj: Do të avancojmë kornizën ligjore që mundëson mbrojtjen efektive të shtretërve të lumenjve si nga kapja ilegale e rrjedhave ujore, ashtu edhe nga keqpërdorimi i rezervuarëve natyrorë dhe artificial.⁴ Përveç këtyre definimeve të përgjithshme në formë të prioritetit, nuk ka ndonjë plan konkret për ndotjen e ajrit nga termocentralet, nga transporti, ngrohja në amvisëri etj. Më tutje, asnjë plan s'është shpalosur as sa i takon ndotjes së lumenjve qoftë të rrjedhave nëntokësore nga aktiviteti bujqësor, ujërat e zeza etj., qoftë të ujërave sipërfaqësore nga hedhja e mbeturinave, aktiviteti ekonomik dhe minerar ilegal etj.

Partia Demokratike e Kosovës gjithashtu ka folur në terma gjeneral dhe ka dështuar të ofroj zgjidhje të detajuara:

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit nga ndotja industriale e ajrit, PDK-ja ka parashikuar masa konkrete në TC Kosova B dhe njësitë përkatëse. Konkretisht, është parashikuar që të përkrahen masat ambientale në kuadër të TC Kosova B deri në vitin 2027, sipas rekomandimit të studimit të bërë, vlera totale për financim sillet rreth 350 milionë euro. Po ashtu, synohet dekarbonizimi i sektorit të energjisë, për periudhën 2030 e tutje⁵

Lidhja Demokratike e Kosovës ka vendosur vetëm një postulat të përgjithshëm: Standardet për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe tokës.⁶ Ndërsa, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon ndërtim të sistemeve të ngrohjes qendrore për të ulur efektet e ndotjes. Në përgjithësi, ndotja e ajrit, tokës dhe ujit nuk ka marrë as për së afërmi vëmendjen e subjekteve politike në programet e tyre për këto zgjedhje.

Biodiversiteti dhe mbrojtja e ekosistemeve



Asnjëra nga subjektet politike të analizuara, pra LVV, LDK, PDK dhe AAK nuk e kanë përfshirë fare biodiversitetin dhe mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore si dhe ekosistemet e tyre në programet zgjedhore!

Përfundime dhe Rekomandime

Programet e partive politike për zgjedhjet e 14 shkurtit janë ndër programet më të dobëta të cilësdo palë zgjedhje që janë mbajtur në Kosovë sa i takon fushës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe agjendës së gjelbër. Asnjë nga programet e partive politike nuk përmban as për së afërmi agjendën e gjelbër dhe konditat kryesore që kjo agjendë përmban. Partitë politike kanë dështuar që të

⁴ Lëvizja Vetëvendosje, (2021), Prioritetet për KREJT qytetarët DREJT së ardhmes, faqe 16, i qasshëm në https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2021/02/Programi-2021-LV.pdf?fbclid=IwAR0v6HyZ1W3bhDSFiQ9EQ_-23K5_hENTchjFwkjF7fhrptKsjRsD8D5jfNs (qasur në shkurt, 2021)

⁵ Partia Demokratike e Kosovës, (2021), Rimëkëmbje dhe Zhvillim i Qëndrueshëm Ekonomik, faqe 75.

⁶ Lidhja Demokratike e Kosovës, (2021), Programi Qeverisës i Lidhjes Demokratike të Kosovë, faqe 10, i qasshëm në https://www.ldk-ks.eu/wp-content/uploads/2021/02/Programi_Qeverise%CC%88s_shtetishtet.pdf (qasur në shkurt, 2021)

parashohin masa konkrete për të realizuar Agjendën e Gjelbër dhe për të siguruar një tranzicion të mirëfilltë energjetik dhe një Kosovë larg karbonit. Ofertave zgjedhore u mungojnë edhe konceptet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm. Madje, shumica e partive nuk ofrojnë masa konkrete as për ndotjen e ajrit që është ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve.

Partitë politike kanë dështuar të japin opsione të qarta sa i takon dekarbonizimit. Ato nuk kanë përmendur as domosdoshmërinë, as afatet kohore dhe as mënyrën e realizimit të saj. Partia Demokratike e Kosovës e ka përmendur si mundësi pas vitit 2030 por në të njëjtën kohë ka propozuar ndërtimin e termocentralit nga qymyri dhe s'ka dhënë asnjë detaj në lidhje me mënyrën si e kanë menduar dekarbonizimin të ndodhë.

Partitë politike dëshpërojnë edhe në fushën e energjisë. Në pjesën e eficiencës pothuaj të gjitha partitë kanë qenë sipërfaqësore. LVV dhe LDK udhëheqin me premtimet më të mjegullta në fushën e eficiencës ndërsa sa i takon të ardhmes energjetike PDK dhe AAK e shohin qymyrin ende si zgjidhje të parë të investimeve në fushën e energjisë. Ajo që është edhe më dëshpëruese është që asnjëra nga subjektet nuk ka paraqitur një plan konkret për promovimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë dhe as për transformimin e sektorit. LDK ka listuar liberalizimin e tregut dhe integrimin e tij me rajonin si objektiva gjë që janë pozitive, por nuk e ka shoqëruar me ndonjë shpjegim të mëtejshëm.

Ekonomia qarkore gjithashtu nuk është prioritetuar në programet e subjekteve politike për zgjedhjet e 14 shkurtit. Ndonëse shumica e subjekteve të analizuara e përmendin shkarazi trajtimin e mbeturinave për shembull, asnjëra nga to nuk jep detaje dhe nuk ka ndonjë propozim inovativ në këtë fushë. Nevojitet që partitë të detajojnë planet e tyre sa i takon fushës së trajtimit të mbeturinave veçanërisht duke promovuar riciklimin e materialeve pastaj ndalimin e plastikës, nxitjen e masave fiskale për produkte të riciklueshme etj.

Ndotja e ajrit, tokës dhe ujit vazhdojnë të jenë problem thelbësor për jetën e qytetarëve dhe në qendër të zbatimit të agjendës së gjelbër për Kosovën. Megjithatë, ajo nuk përbën pjesën thelbësore të programeve të partive politike e madje, pjesa dërrmuese e prioritetëve të fushës as që janë përmendur. Partitë politike nuk kanë ide se cilat do të jenë masat konkrete për uljen e emetimeve, elektrifikimin e bazuar në burime të ripërtrishme të energjisë, transformimin e sistemeve të ngrohjes, incentivave për transport të gjelbër etj.

Biodiversiteti nuk ka zënë fare vend në programet e partive politike. Qindra specie janë të rrezikuara në Kosovë si rrjedhojë e shpyllëzimit, zhvendosjes së ekosistemeve, aktiviteteve minerare etj. Partitë politike nuk kanë përfshirë fare asnjë nga këto sfida si dhe masat që do të ndërmerren në programet e tyre politike. Është për keqardhje që subjektet që garojnë në këto zgjedhje nuk prioritojnë njërin nga shtyllat kryesore të agjendës së gjelbër.

Me këto oferta zgjedhore, partitë politike dëshmojnë qartë se agjenda e gjelbër nuk është në prioritet të tyre. Më së paku, ky kualitet i programeve politike tregon një arrogancë të subjekteve që garojnë dhe një mungesë të përgjegjësisë që qytetarët të kenë rastin të njihen me qëndrimet e tyre dhe pozicionin e secilës parti karshi agjendës së gjelbër. Këto programe, janë një rast i humbur që qytetarët të kenë mundësinë të krahasojnë programet politike, t'u ofrohet një rrugë e qartë e transformimit drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të ofrohet një bazë e mirë për kërkim të llogarisë nesër.

